



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: ARTE

LËNDA: HISTORIA E ARTIT SHQIPTAR

KODI: 1.1

PROGRAMI I LËNDËS HISTORIA E ARTIT SHQIPTAR

KLASA 10

TIRANË, SHTATOR 2008

Historia e artit shqiptar është një nga lëndët që përmban fusha e arteve në gjimnaz, dhe ashtu si të gjitha lëndët e tjera të gjimnazit, luan një rol të rëndësishëm në edukimin dhe formimin artistik të nxënësve të kësaj grupmoshe, duke thelluar njohuritë për artin kombëtar, zhvilluar ndjenjën e së bukurës dhe duke u mësuar atyre rrugët për të kuptuar zhvillimin e artit në Shqipëri e më gjerë në trevat shqiptare.

Historia e artit shqiptar jep njohuri të përgjithshme për zhvillimin e artit shqiptar dhe trevave të tjera shqiptare në periudha të ndryshme historike, duke shpjeguar ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore në këto periudha.

Kjo lëndë komunikon nëpërmjet trajtimit logjiko-historik, momentet më të spikatura të zhvillimit të këtyre arteve. Përmes shtjellimit historik të artit shqiptar në Shqipëri e më gjerë, synohet të njihen vlerat e veprave artistike shqiptare në të gjitha fushat e sipër përmendura. Njohuritë zhvillohen në rrafshin historik, estetik, teoriko – artistik, duke iu referuar zhvillimeve dhe informacionit aktual mbi gjinitë e shumëllojshme të artit shqiptar.

Kjo lëndë, përmes njohjes dhe studimit të përmbajtjes që ajo ofron, kontribuon në *zhvillimin e identitetit kombëtar* të nxënësve. Ajo u jep mundësinë atyre të shohin vetveten dhe artin që ata përfaqësojnë si pjesë të kulturave të ndryshme evropiane, po aq të lashtë sa shumë kultura të tjera.

1. SYNIMI I LËNDËS

Ky program synon:

Të zhvillojë formimin artistik dhe kulturor të nxënësve nëpërmjet njohjes së vlerave të artit shqiptar; të sigurojë kulturën e domosdoshme për të kuptuar artet, interpretuar e vlerësuar kulturën dhe veprat e artit kombëtar.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi nxënës/i, - ja:

- të analizojë përmes një terminologjie artistike zhvillimin e artit shqiptar në periudha dhe kontekste të ndryshme, bazuar në vlerat artistike të secilës;
- të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik dhe krijues gjatë interpretimit të veprave të ndryshme artistike;
- të identifikojë veprat e artit (art pamor, muzikë, kërcim, teatër dhe kinema) nëpërmjet periudhave, përmbajtjeve, temave, stileve, metodave, teknikave dhe materialeve;
- të zhvillojë vetëdijen kombëtare nëpërmjet trajtimit historik të vlerave artistike kombëtare.

3. OBJEKTIVAT SIPAS LINJAVE

36 javë x 1 orë = 36 orë

Linja 1: Historia e artit pamor shqiptar

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë, nxënësit njihen me zhvillimin e artit figurativ në Shqipëri në periudha të ndryshme, me karakteristikat historike, shoqërore dhe kulturore të krijimit të veprave të artit në këto periudha. Ata analizojnë dhe krahasojnë vepra të ndryshme arti, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike. Për herë të parë vjen njohja konkrete, përmes vlerave reale të artit figurativ kombëtar dhe përfaqësuesve të tij në periudha të ndryshme.

Orët e sugjeruara: 10

Linja	Objektivat
Historia e artit pamor shqiptar	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të zbatojë hapat që ndjekin <i>historianët dhe kritikët e artit</i> në vlerësimin e një vepre arti pamor (përshkrimi, analiza, interpretimi, gjykimi);• të analizojë fillimet e artit pamor në Shqipëri dhe në trevat e tjera shqiptare;• të përdorë kërkimet, krahasimet, diskutimet dhe debatin për analizën e <i>karakteristikave historike, stilistike dhe estetike</i> të artit pamor dhe arkitekturës në Shqipëri dhe në trevat e tjera shqiptare.<ul style="list-style-type: none">› Arti pamor i periudhës parahistorike.› Arti pamor shqiptar dhe ndikimi nga kultura të tjera: kultura ilire, Arti i qyteteve antike (Butrinti, Apolonia, Dyrrahu), mozaikët e lashtë në Shqipëri.› Arti pamor i artizanëve, shqiptarëve të hershëm. Arti bizantin.› Arti pamor në Rilindje: Onufri, arti në Shqipëri – ikonografët e shek XVIII.› Arti pamor në periudhën e Pavarësisë, arti pamor në vitet njëzet të shek. XX.› Arti pamor i realizmit socialist në Shqipëri.› Lindja e institucioneve dhe shkollave të para të artit

	<p>pamor.</p> <ul style="list-style-type: none"> • të mbajë qëndrim personal gjatë analizës që i bën zhvillimit historik të veprave të artit pamor (p.sh. në një debat, ese, projekt etj.), sipas disa kriterëve: <ul style="list-style-type: none"> - periudhës dhe autorit, - ndikimeve, - mjedisit social e shoqëror, - mesazhit që përcjell, - teknikave dhe materialeve të përdorura. • të ideojë vetë ose në grup, një projekt që ka të bëjë me zhvillimin historik të një arti të caktuar, si p.sh.: evoluimi i artit pamor nga shek. XVIII Onufri deri në ditët tona, vepra dhe përfaqësues; • të diskutojë mbi ndikimin e artit te vetja dhe në shoqëri, pa paragjykuar mendimet e të tjerëve, p.sh.: parapëlqimet e një arti të një periudhe të caktuar (arti i realizmit socialist etj).; • të marrë pjesë si pjesëmarrës ose organizator në veprimtari të ndryshme artistike në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton, në komunitet dhe shoqëri.
--	--

Linja 2: Historia e muzikës shqiptare

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë njeh nxënësit me zhvillimin e muzikës shqiptare dhe më gjerë në periudha të ndryshme, shpjegon karakteristikat dhe ndikimet e muzikës shqiptare në kontekstin historik, shoqëror dhe kulturor. Nxënësit, përmes një procesi kritik, komunikimit dhe përdorimit të një gjuhe të thjeshtë muzikore, aftësohen për të zhvilluar përgjigjet e tyre emocionale ndaj muzikës shqiptare që ata dëgjojnë, qoftë kjo tradicionale, klasike apo moderne.

Orët e sugjeruara: 10

Linja	Objektivat
Historia e muzikës shqiptare	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të klasifikojë zhvillimet e muzikës shqiptare dhe trevave të tjera në periudha të ndryshme historike, duke u mbështetur në karakteristikat specifike, historike, stilistike dhe estetike të veprave më të spikatura; <ul style="list-style-type: none"> > Veçoritë e zhvillimit muzikor shqiptar në <i>lashtësi, mesjetë, Rilindje dhe shek. XIX -XX</i>: <ul style="list-style-type: none"> - muzika shqiptare në periudhën e Mesjetës:

	<ul style="list-style-type: none"> - muzika ilire – figura e Niket Dardanit himnografi shqiptar; - muzika bizantine – Jan Kukuzeli dhe shkrimi muzikor; - muzika shqiptare e Rilindjes dhe gjatë Pavarësisë; - Fan Noli dhe vepra e tij; - muzika shqiptare pas viteve ‘45: muzika vokale dhe instrumentale. Veprat dhe përfaqësuesit e tyre; - muzika e filmit, veprat dhe përfaqësuesit e tyre; - muzika kosovare, veprat kryesore dhe përfaqësuesit e tyre; <p>> Lindja e institucioneve dhe shkollave të para artistike;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të analizojë një vepër muzikore, duke u mbështetur në disa kriterë, si: <ul style="list-style-type: none"> - periudhën - kompozitorin - mjedisin social, shoqëror, politik, ku u krijua vepra - mesazhi që përcjell etj. • të debatojë mbi një vepër muzikore, duke e nisur analizën nga përdorimi i elementeve muzikore (<i>ritmi, melodia, harmonia etj.</i>); • të diskutojë mbi ndikimin e muzikës te vetja dhe në shoqëri pa paragjykuar mendimet e të tjerëve, p.sh.: ndikimin e muzikës moderne etj.; • të marrë pjesë si pjesëmarrës apo organizator në veprimtari të ndryshme muzikore në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton, komunitet dhe shoqëri.
--	---

Linja 3: Historia e kërcimit shqiptar

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë i njeh nxënësit me njohuri të përgjithshme të zhvillimit të kërcimit shqiptar, duke renditur karakteristikat e veçanta të përfaqësimit kulturor shqiptar.

Kjo linjë njeh nxënësit me veprat kryesore e më të spikatura të kërcimit shqiptar, si dhe me përfaqësuesit kryesorë të këtyre veprave.

Orët e sugjeruara: 6

Linja	Objektivat
	Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:

<p>Historia e kërcimit shqiptar</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të klasifikojë dhe analizojë zhvillimet e kërcimit shqiptar që nga fillimet e saj, duke nxjerrë në pah karakteristikat specifike, historike, stilistike dhe estetike të kërcimeve të ndryshme; • të përshkruajë zhvillimin e artit të kërcimit në Shqipëri dhe më gjerë, duke analizuar veprat dhe përfaqësuesit që i krijuan pas viteve 45': <ul style="list-style-type: none"> › vallja dhe karakteristikat kryesore sipas trevave në Shqipëri e më gjerë; › zhvillimi i baletit në Shqipëri në shek. XX; › veprat më të rëndësishme dhe përfaqësuesit e koreografisë shqiptare; › lindja e institucioneve artistike dhe shkollave të para koreografike; • të shpjegojë vlerat artistike të veprave koreografike në Shqipëri dhe më gjerë; • të përdorë kërkimet, krahasimet, diskutimet dhe debatin, rreth zhvillimit të kërcimit dhe krijimit të veprave koreografike me përfaqësues kryesorë shqiptarë; • të marrë pjesë si pjesëmarrës/e ose organizator/e në veprimtari të ndryshme artistike në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton, në komunitet dhe shoqëri.
--	---

Linja 4: Historia e teatrit dhe kinemasë

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë njihen me zhvillimin e teatrit në Shqipëri në periudha të ndryshme, karakteristikat e tij historike, shoqërore dhe kulturore në këto periudha. Nxënësit do të studiojnë elementet kryesore që përbëjnë teatrin, zhvillimin e dramës, skenës, të interpretimit të aktorit dhe të regjisorit etj. Në këtë linjë nxënësve do t'u jepet mundësia të thellojnë aftësitë e tyre kritike dhe analitike nëpërmjet detyrave që do të kryejnë gjatë analizave historike, sociale, stilistike, dramaturgjike të disa prej veprave më të shquara dhe më përfaqësuese të dramaturgjisë shqiptare. Gjithashtu, nxënësit njihen me zhvillimin e kinemasë dhe filmit në Shqipëri dhe më gjerë.

Orët e sugjeruara: 10

Linja	Objektivat
<p>Historia e teatrit dhe kinemasë shqiptare</p>	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të klasifikojë zhvillimet e artit dramatik dhe kinematografik në Shqipëri e më gjerë, mbështetur në karakteristikat <i>specifike, historike, stilistike</i> dhe <i>estetike</i> të veprave të veçanta;

	<ul style="list-style-type: none"> • të përdorë kërkimet, krahasimet, diskutimet dhe debatin rreth zhvillimit të kulturës skenike, si dhe veprave e përfaqësuesve kryesorë shqiptarë; <ul style="list-style-type: none"> › Teatri shqiptar: <ul style="list-style-type: none"> - Teatri në antikitet - Teatri folklorik - Teatri në periudhën e Rilindjes Kombëtare. › Teatri në periudhën: <ul style="list-style-type: none"> - 1912- 1945 - pas vitit 1945 - Teatri në dekadën e fundit › Kinemaja në Shqipëri e Kosovë. <ul style="list-style-type: none"> - filmi dokumentar - filmi artistik - animacioni › lindja e institucioneve artistike dhe shkollave të para teatrale; • të analizojë një vepër teatrale apo kinematografike duke u mbështetur në disa kriterë: <ul style="list-style-type: none"> - periudhën dhe autorin, - ndikimet, - mjedisin social e shoqëror ku u krijua vepra, - mesazhi që përcjell, • diskutojë <i>ndikimet</i> e një zhanri teatral apo kinematografik tek vetja dhe tek shokët, pa paragjykuar mendimet e të tjerëve; • të vlerësojë <i>rolin</i> dhe <i>funksionin</i> e teatrit në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton komunitet dhe shoqëri, duke kontribuar si pjesëtar aktiv në të; • të krahasojë veprat e artit skenik (teatër apo kinema) duke nxjerrë në pah <i>specifikat e veprave</i> të marra në analizë; • të përdorë elementet skenikë për të ngritur një argument, opinion, mendim në punët e veta përmes një ese-je, diskutimi, projekti kurrikular etj; • të analizojë <i>cilësinë</i> e realizimit të veprave të ndryshme skenike apo kinematografike, duke përdorur një fjalor të përshtatshëm artistik.
--	--

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e historisë së artit shqiptar. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare të arteve, ku kjo lëndë bën

pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit,
- Synimeve të linjave ndërkurrikulare,
- Vlerësimin të nxënësit me notë,
- Parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Historia e artit shqiptar në gjimnaz studiohet në klasën e 10, në 36 orë mësimore gjithsej, me 1 orë në javë. Programi i Historisë së artit shqiptar do të thellojë dhe zgjerojë përvojat e fituara nga nxënësit në arsimin e detyruar, në lëndët edukim figurativ dhe muzikor, si dhe zhvillojë njohuritë për artin skenik si: kërcimi, teatri e kinemaja. Programi i historisë së artit shqiptar organizohet sipas linjave për artin figurativ, muzikën, teatrin dhe kinemanë, kërcimin.

Përmes këtij programi nxënësit njohin, studiojnë dhe vlerësojnë periudhat në të cilat u zhvillua arti në Shqipëri e më gjerë, veprat dhe përfaqësuesit e çdo periudhe, karakteristikat për secilën vepër të marrë në studim. Ata përshkruajnë, krahasojnë, ngrenë hipoteza dhe mbajnë qëndrim kritik, duke vlerësuar opinionet e gjithsecilit për çdo vepër arti të marrë në analizë.

Për zhvillimin e kësaj lënde, mësues/i,-ja punon vetëm dhe në grup, zhvillon biseda, konkurse, veprimtari artistike etj.

Zhvillimi i të menduarit kritik për zhvillimin e qëndrimeve dhe vlerësimin e një vepre arti.

Për të formuar njohuritë dhe qëndrimet artistike të nxënësve në lëndën e historisë së artit shqiptar, në përshtatje me natyrën që kanë artet në përgjithësi, mësues/i,-ja duhet të zhvillojë tek nxënësit kulturën e nevojshme artistike, të domosdoshme për studimin e karakteristikave të veprave të autorëve të ndryshëm shqiptarë. Kjo i aftëson nxënësit jo vetëm në njohjen e veprave artistike të fushave të ndryshme te artit, por edhe në reagimin e mbajtjen e një qëndrimi profesional ndaj tyre, duke zhvilluar respekt dhe dashuri ndaj artit të vendit të tyre dhe përfaqësuesve të saj. Programi i “Historisë së artit shqiptar” kërkon nga zbatuesit që kjo lëndë të mos zhvillohet vetëm si një lëndë teorike, por edhe si një lëndë që kërkon zhvillimin e aftësive analizuuese, krahasuese dhe vlerësuese, ku çdo nxënës fiton aftësitë për të mbajtur qëndrim ndaj veprave artistike shqiptare.

Për zhvillimin e kësaj lënde, rol të rëndësishëm luajnë mjediset, metodat dhe teknologjitë mësimore (TV, video, magnetofon, Cd etj.). Për realizimin e projekteve, në varësi nga tema e tyre, kërkohet bashkëpunimi dhe puna në grup.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia për të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi, si dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

P.sh.: Objektivi: “të analizojë fillimet e artit pamor në Shqipëri dhe në trevat e tjera shqiptare;” kërkon që të gjithë nxënësit të njohin zhvillimet e artit figurativ shqiptar nga fillimet e saj e deri në ditët tona. Nëse një mësues nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor.

Një objektivi përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm.

Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh.: “të mbajë qëndrim personal gjatë analizës që i bën zhvillimit historik të veprave të artit (p.sh. në një debat, ese, projekt etj.), sipas disa kriterëve:

- periudhës dhe autorit,
- ndikimeve,
- mjedisit social e shoqëror,
- mesazhit që përcjell,
- teknikave dhe materialeve të përdorura.

kërkon që të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që të krijojnë një qëndrim personal në mënyrë të sigurt, por jo nga të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel i qëndrimit ndaj veprave të ndryshme artistike.

Një tjetër nivel arritjeje është ideimi *i një projekti apo detyre të dhënë* nga situata të ngjashme me shembujt e sapo mësuar. Një nivel më i lartë se ky është përdorimi i këtyre njohurive në situata të reja për nxënësin, pavarësisht nga kapitulli që po studion. Një nivel edhe më i lartë do të ishte përdorimi dhe zbatimi në njohuritë e linjave të tjera të artit shqiptar, pastaj të lëndëve të tjera e më në fund në një situatë të stimuluar dhe nga vetë bota reale.

Orët mësimore

Programi i “Historia e artit shqiptar” është strukturuar në 4 blloqe (linja apo kapituj) që vijnë njëra pas tjetrës, por kjo nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë.

Domethënë, mësues/i,-ja mund të vendosë të vazhdojë më ngadalë kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave mësimore, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së “Historisë ë artit shqiptar” afërsisht **70%** e totalit të orëve mësimore janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore, ndërsa **30%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda një linje apo kapitulli të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Testimin e njohurive-bazë;
- Integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë paraardhëse;

- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera brenda fushës së arteve dhe më tej.
- (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- Përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- *Aftësive të posaçme lëndore:*

krijuese - shkrimin e një eseje, duke krahasuar karakteristikat midis dy veprave të artit qoftë kjo vepër nga arti pamor, muzikor koreografik apo skenik dhe sjellë opinionin dhe qëndrimin personal;

komunikuese - komunikimin e saktë të njohurive, mendimeve dhe qëndrimeve rreth artit shqiptar dhe veprave të ndryshme, përmes një terminologjie artistike;

analizuese - analizimin e një vepre arti përmes elementeve dhe parimeve të artit pamor, të cilat përbëjnë një vepër, dhe që ndihmojnë për krijimin e qëndrimeve personale ndaj artit shqiptar;

krahasuese - krahasimin dhe renditjen e karakteristikave të dy veprave artistike, qofshin këto muzikore, figurative, skenike apo koreografike të realizuara nga autorë të ndryshëm, por që i përkasin të njëjtës periudhë historike.

- *Formimit të qëndrimeve*, si qëndrimi etiko-social etj., dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike bazuar mbi një tematikë të caktuar, apo projekte kurrikulare etj.

Me nxënësit me vështirësi në të nxënë, duhet të punohet veçmas për realizimin e detyrave dhe rezultateve.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat, programin lëndor dhe mësuesi/ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët në veçanti.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë, dhe në bashkëpunim me nxënësit, një larmi mënyrash vlerësimi, që kanë të bëjnë me:

1. përdorimin e saktë të *njohurive mbi fusha të ndryshme të arteve*;
2. dallimin e individit (nxënësit) më të suksesshëm gjatë debatit për krahasimin e dy veprave të artit shqiptar (art figurativ, muzikë, teatër dhe kinema apo kërcim);
3. krahasimin e eseve në trajtimin e çështjeve të zhvillimeve që ka ndjekur arti shqiptar dhe vlerat e veprave të krijuara nga krijues të çdo fushe arti, ku sillen opinione apo mendime, argumentohet dhe krijohet një qëndrim personal ndaj çështjes së ngritur.

Nxënës/i, - ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet në punë të ndryshme, si: shkrimi i një ese-je etj., vëzhgimi, dëgjimi i një vepre artistike dhe mbajtja qëndrim, marrja pjesë në veprimtari të ndryshme artistike që organizon shkolla etj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj.

Nxënës/i, - ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet në punë konkrete si psh: *shkrimi i një eseje, ndjekja dhe pjesëmarrja në jetën artistike të komunitetit etj.*

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi/ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësues/i,-ja duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra tematike (ese), projekte kurrikulare, të gjitha në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.

